



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 9 Shkurt 2021

Nr: 3

VENDIM

PËR

KRITERET E CAKTIMIT DHE ORGANIZIMIT TË VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 09.02.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave.

**BAZA LIGJORE:** Neni 20, paragrafët 1, shkronja "a", dhe 3, neni 93, neni 94, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, shkronja "a", nenit 93 dhe nenit 94, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,



Data: 9 Shkurt 2021

Nr: 3

Kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave

## VENDOSI:

### KREU I TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### **Qëllimi dhe objekti**

Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave për caktimin dhe organizimin e Vendit të Numërimit të Votave, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Objekt i këtij vendimi është miratimi i skemës organizative të funksionimit dhe numrit të tavolinave të numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave.

#### Neni 2

#### **Përkufizime**

Në këtë Vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “KQZ” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
2. “KZAZ” është Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që ngrihet dhe funksionon në përputhje me Kodin Zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore.
3. “VNV” është Vendi i Numërimit të Votave, mjedis i caktuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, për zhvillimin e procesit të numërimit të votave.
4. “Tavolinë numërimi” është tryeza e punës, që vihet në dispozicion të grupit të numërimit të votave, për kryerjen e procedurave të numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit dhe plotësimin e tabelës së rezultateve të qendrës së votimit.
5. “Mjediset jashtë VNV” janë hyrja, oborri dhe ambientet përçark oborrit të ndërtesës ku është caktuar Vendi i Numërimit të Votave dhe rreth tij në një rreze prej 150 m nga Vendi i Numërimit të Votave.
6. “ZAZ” është Zona e Administrimit Zgjedhor, territori ku KZAZ ushtron veprimtarinë, dhe përgjigjet për administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve.



### Neni 3

#### Parime të përgjithshme

1. VNV caktohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor, dhe përcaktimeve të këtij Vendimi.
2. Një VNV nuk mund të ketë më pak se tre dhe më shumë se dhjetë tavolina të numërimit të votave.
3. Pajisjet e nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave sigurohen nga KQZ në bashkëpunim me organet e tjera qendrore dhe vendore.
4. Si rregull, VNV nuk ndryshon nga njëra zgjedhje në tjetrën.

### KREU II

#### CAKTIMI DHE KRITERE TEKNIKE TË VNV

### Neni 4

#### Vendndodhja e VNV

1. Prefekti i qarkut, jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, i paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në nenin 93, paragrafët 1 dhe 2, dhe nenin 94 të Kodit Zgjedhor, dhe planimetrinë e mjedisit ku mund të caktohet VNV.
2. Në përzgjedhjen e objektit për caktimin e VNV-së, i jepet përparësi lehtësive logjistike të transportit rrugor, distancës nga qendrat e votimit, hapësirave të mjedisit ku do të krijohet VNV, dhe mundësive për instalimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave.
3. Për caktimin e vendodhjes së VNV-së, mund të përzgjedhet bashkia qendër qarku, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkia brenda territorit të ZAZ-së, apo edhe njësi më e madhe administrative, nëse objektet në territorin e bashkive nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 5 të këtij Vendimi.
4. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve, cakton me vendim vendndodhjen e VNV-së të çdo ZAZ-je.



## Neni 5

### Kritere teknike të VNV

1. VNV-ja caktohet në salla me përmasa të mëdha ose palestra sportive.
2. Objekti ku caktohet VNV, duhet:
  - a) të ketë sistem të sigurtë e të pandërprerë furnizimi me energji elektrike, të mjaftueshëm për të suportuar teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave;
  - b) të ketë sistem ndriçimi në mjediset e brendshme ashtu edhe në mjediset jashtë VNV;
  - c) të ofrojë mundësi për instalimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin e votave;
  - ç) të jetë i pajisur me mjete të mbrojtjes kundra zjarrit si dhe të ndihmës së shpejtë.
3. Sipërfaqja e mjedisit të VNV-së, si rregull, duhet të jetë:
  - a) jo më e vogël se 120 m<sup>2</sup>, për ZAZ të cilat kanë në territorin e tyre deri në 30 qendra votimi;
  - b) jo më e vogël se 150 m<sup>2</sup>, për ZAZ të cilat kanë në territorin e tyre deri në 50 qendra votimi;
  - c) jo më e vogël se 200 m<sup>2</sup>, për ZAZ të cilat kanë në territorin e tyre deri në 80 qendra votimi;
  - ç) jo më e vogël se 300 m<sup>2</sup>, për ZAZ të cilat kanë në territorin e tyre më shumë se 80 qendra votimi.
4. Mjedisi ku caktohet VNV duhet të ketë, për aq sa është e mundur, më shumë se një derë komunikuese me mjedisin e jashtëm.

## KREU III

### NUMRI I TAVOLINAVE TË NUMËRIMIT DHE PAJISJET LOGJISTIKE NË VNV

## Neni 6

### Kriteret për caktimin e tavolinave të numërimit në VNV

1. KZAZ-ja vendos në VNV:
  - a) jo më pak se tre tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka deri në 30 qendra votimi.
  - b) jo më pak se katër tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka nga 31 deri 50 qendra votimi.
  - c) jo më pak se pesë tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka nga 51 deri 80 qendra votimi.



- ç) jo më pak se gjashtë tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka nga 81 deri në 100 qendra votimi.
  - d) jo më pak se shtatë tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka nga 101 deri në 115 qendra votimi.
  - dh) jo më pak se tetë tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka nga 116 deri në 130 qendra votimi.
  - e) jo më pak se nëntë tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka nga 131 deri në 140 qendra votimi.
  - ë) dhjetë tavolina numërimi, kur në territorin e ZAZ ka mbi 140 qendra votimi.
2. Tavinat e numërimit të votave numërtohen nga KZAZ-ja në rend rritës.

#### Neni 7

#### **Pajisjet logjistike në VNV**

1. VNV-të vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë para datës së zgjedhjeve.
2. KZAZ-ja, menjëherë me marrjen në dorëzim të VNV-së, në bashkëpunim me organet e vetqeverisjes vendore, siguron dhe sistemon në VNV pajisjet logjistike të nevojshme, përfshirë edhe ndriçimin e pandërprerë, për mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave.
3. Njësia e vetqeverisjes vendore, në territorin e së cilës është caktuar VNV, siguron pajisjet logjistike për procesin e numërimit të votave:
  - a) tryeza pune me hapësira të mjaftueshme për çdo GNV;
  - b) tryeza pune dhe karrige për KZAZ dhe personelin teknik;
  - c) karrige për anëtarët e GNV dhe vëzhguesit.

#### Neni 8

#### **Instalimi i teknologjisë mbështetëse në VNV**

1. KQZ-ja vendos përdorimin e kamerave regjistruese dhe të monitorëve (ekraneve) në VNV, për të realizuar regjistrimin video të procesit të numërimit të votave dhe vlerësimit të çdo flete votimi.
2. Prefekti i qarkut, merr masat që mjedisi ku është caktuar vendndodhja e VNV-së, sipas parashikimeve të paragrafit 4 të nenit 4 të këtij Vendimi, të vendoset menjëherë në dispozicion të KQZ-së për instalimin e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.



3. KZAZ-ja, në bashkëpunim me organet e vetqeverisjes vendore, merr masa për krijimin e kushteve të përshtatshme, ndjek dhe monitoron procesin e instalimit e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.
4. Kamerat me rezolucion të lartë instalohen mbi tavolinën e numërimit në mënyrë që në monitor fleta e votimit të shfaqet e plotë dhe të realizohet qartë regjistrimi video i vlerësimit të çdo flete votimi, regjistrimi video i numërimit të fletëve të votimit, dhe numri i qendrës së votimit.
5. Monitorët vendosen përballë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, dhe transmetojnë në kohë reale regjistrimin filmik të numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit.

## KREU IV ORGANIZIMI I VNV

### Neni 9

#### **Përgatitja e VNV**

1. KZAZ-ja, jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve, organizon dhe përgatit VNV në mënyrë të tillë që të garantohet zhvillimi i qetë, i rregullt dhe në transparencë të plotë i procesit të numërimit të votave.
2. Për çdo grup numërimi vendoset tavolinë numerimi/tavolina pune me hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procedurave të numërimit dhe vlerësimit të fletëve të votimit.
3. Tryezat e punës së grupeve të numërimit dhe vendi i anëtarëve të KZAZ-së duhet të jenë në të njëjtën mjedis ku kryhet procesi i numërimit të votave.
4. Tavolinat e numërimit duhet të shikohen pa asnjë pengesë nga anëtarët e KZAZ-së, vëzhguesit e akredituar, kandidatët dhe përfaqësuesit e medias.

### Neni 10

#### **Skema organizative e funksionimit të VNV**

Skema organizative e funksionimit të VNV-së, do të jetë sipas planvendosjes tip në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij Vendimi, duke respektuar kriteret:

a) Hapësira ku vendosen tavolinat e numërimit:

- i. të jetë e mjaftueshme, duke siguruar vendosjen e tyre në distancë dhe të barazlarguar nga njëra-tjetra;



Data: 9 Shkurt 2021  
Nr. 3

Kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave

- ii. të jetë përballë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore, vëzhguesit e akredituar nga KQZ, kandidatët dhe mediat;
  - iii. të jetë e ndarë qartë nga hapësira ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar, kandidatët dhe mediat.
- b) Hapësira në dispozicion të çdo GNV:
- i. të shmangë cdo mundësi për kontakt fizik të personave të pranishëm në VNV me materialet e votimit;
  - ii. të jetë e mjaftueshme për tavolinën e numërimit, kutinë e votimit dhe/ose kutinë e materialeve të votimit që vendosen pranë saj, si dhe për karrige për çdo anëtar të GNV;
  - iii. të mundësojnë instalimin e teknologjisë mbështetëse për numërimin dhe vlerësimin e votave.
- c) Hapësira ku do të vendosen kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit që merren në dorëzim nga Komisionet e Qendrave të Votimit, si dhe hapësira ku ato do të vendosen pas numërimit:
- i. të jenë në të njëjtin mjedis ku kryhet numërimi i votave;
  - ii. të jenë të garantuara nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar.
- ç) Hapësira ku do të qëndrojnë vëzhguesit e akredituar:
- i. të jetë përballë dhe në largësi të vogël nga hapësira ku vendosen tavolinat e numërimit;
  - ii. të jetë në distancë jo më pak se një metër e gjysëm nga monitorët kur përdoret teknologjia mbështetëse për numërimin e votave;
  - iii. në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk duhet cënuar mundësia e vëzhguesve për të ndjekur nga afër procesin e numërimit të votave dhe shfaqjen e fletëve të votimit në monitorët e vendosur, për këtë qëllim.
- d) Vendi ku do të afishohen kopje të tabelës së rezultatit të qendrave të votimit, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, kopje të tabelës përmbledhëse të rezultatit të ZAZ-së, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së:
- i. të caktohet pranë hapësirës ku qëndrojnë vëzhguesit e akredituar;
  - ii. të shikohet pa asnjë pengesë nga të gjithë vëzhguesit e akredituar.

Neni 11



Data: 9 Shkurt 2021  
Nr. 3

Kriteret e cakimit dhe organizimit të Vendi të Numërimit të Votave

## Prezantimi i Vendit të Numërimit të Votave

1. KZAZ-ja, jo më vonë se pesë ditë para datës së zgjedhjeve, ka kryer organizimin dhe sistemimin e VNV-së, sipas kritereve të parashikuara në paragrafin 5 të nenit 9 të këtij Vendimi, dhe planvendosjes tip në lidhjen 1.
2. KZAZ, jo më vonë se afati i parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, ka organizuar dhe sistemuar VNV-në me pajisjet logjistike të siguruara në bashkëpunim me pushtetin vendor, dhe pajisjet e dërguara nga KQZ:
  - a) tavolinë pune dhe 8 karrige për KZAZ-në;
  - b) tavolinë pune dhe 2 karrige për ndihmësit teknik;
  - c) tavolinë numërimi për çdo GNV, që krijohet duke bashkuar dy tavolina pune, dhe katër karrige për çdo tavolinë numërimi të votave;
  - ç) shenjën, në sipërfaqen e tavolinës së numërimit, e cila gjatë rregjistrimit në kamer evidenton qartësisht numrin i grupit të numërimit dhe numrin e qendrës së votimit që numërohet;
  - d) kompjuter, printer, fotokopje, skaner dhe linjë telefonike për KZAZ-në;
  - dh) kamerat rregjistruese të montuara mbi çdo tavolinë numërimi;
  - e) monitorët të vendosur për çdo tavolinë numërimi;
  - ë) strukturat ndarëse të hapësirës së vëzhguesve, kandidatëve dhe mediave me hapësirën për numërimin e votave;
  - f) ka vendosur pranë çdo tavoline numërimi tabela indentifikuese me numrin përkatës për çdo GNV;
  - g) ka vendosur në hyrje të objektit ku është vendosur VNV, tabelën indentifikuese të VNV-së me numrin përkatës të ZAZ-së;
  - gj) ka vendosur shenja orientuese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV.
3. KZAZ-ja, jo më vonë se pesë ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të VNV subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve.
4. Në çdo rast, institucioni që administron objektin ku është vendosur VNV-ja, bashkëpunon për sigurimin e pajisjeve logjistike të parashikuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të paragrafit 2 të këtij neni.

### KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI



Data: 9 Shkurt 2021  
Nr. 3

Kriteret e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave



Neni 12  
**Shfuqizime**

1. Udhëzimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Nr.4, datë 9.04.2015 “Për mënyrën e caktimit dhe organizimit të Vendit të Numërimit të Votave, kriteret për caktimin e numrit të Grupeve të Numërimit për çdo Vend të Numërimit të Votave, përcaktimin e rregullave për ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit”, shfuqizohet.

Neni 13  
**Hyrja në fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Ilirjana NANO - Kryetare**

**Arens ÇELA - Anëtar**

**Dritan ÇAKA - Anëtar**

**Helga VUKAJ - Anëtare**

**Muharrem ÇAKAJ - Anëtar**




**LEGJENDA**

- Emërtimi
- Nivësi numërimi për GN
- Copë 5
- Shprehja në tavolinën e numërimit (Nr.QV)
- Copë 5
- Strukturë ndarëse
- Mieter 23.754
- Tabelat identifikuese e GN-Ve
- Copë 5
- Tryeza punë KZAZ, ndihmësit teknik
- Copë 2
- Karrige
- Kopë 52

**PLANVENDOSJE TIP  
E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE**

Lidhja 1

23754mm



*(Handwritten signatures and initials)*


**LEGJENDA**

Emërtimi	Njësia	Sasia
Tavolina numërimi për GN	Copë	5
Shenja në tavolinën e numërimit (Nr.QV/Nr.GN)	Copë	5
Strukturë ndërtese	Metër	23.754
Tabela identifikuese e GN-Ve	Copë	5
Tryeza punë KZAZ, ndihmësit teknik	Copë	2
Karrige	Copë	52

**PLANVENDOSJE TIP  
E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE**

Lidhja 1

23754mm



*[Handwritten signature]*